

Klasa politike kërkon ndryshim, ndërsa populli stabilitet

Analiza e Claude Moniquet, Presidenti i Qendrës Strategjike Europiane të Inteligjencës (ESISC) për procesin zgjedhor në Shqipëri, thekson se parlamenti i ardhshëm do të pushtohet nga dy partitë kryesore, por ka shtuar se faktor në formimin qeverisë do të jetë LSI.

“Kur mbeten më pak se një javë nga zgjedhjet e përgjithshme elektorale, klasa politike në pushtet vazhdon të pretendojë dhe të premtojë ndryshim. Për më tepër, në emër të “ndryshimit”, dy partitë kryesore, ajo Socialiste dhe Demokratike, institucionalizuan bipolarizimin e sistemit elektoral”, - thuhet në analizën e Moniquet.

Reforma elektorale, sipas tij, solli monopolizimin e sistemit zgjedhor nga 2 partitë politike, PS dhe PD, ku shumë personalitete të politikës shqiptare të 20 viteve të fundit u përjashtuan nga listat zgjedhore.

Presidenti i ESISC nënvizon se fjala ndryshim është lokomotiva e kësaj fushate.

“Çuditërisht, në këtë fushatë elektorale të dy koalicionet kanë si fjalë kyçe ‘ndryshimin’. Klasa politike e Shqipërisë bën thirrje për ndryshim, ndërkohë që individët e thjeshtë janë të shkatërruar nga ndryshimet shoqërore-politike dhe janë duke kërkuar stabilitet.

Në konkluzionin e tij ai shprehet se “pavarësisht dy partive kryesore, faktori kyç në formimin e qeverisë së re dhe i cili do të përcaktojë fitoren e 28 Qershorit, është LSI dhe aleatët e saj”, duke shtuar si skenar më të mundshëm koalicion mes liderëve të Majtë.

E Merkure, 24 Qershor 2009